



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KANCELARI

Nr. 4133/2 prot

Tiranë, më 10.09.2024

Lënda: Njoftim për përfundimin e verifikimit paraprak të kandidatëve pjesëmarrës në fazën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin e kategorisë ekzekutive Specialist i teknologjisë së informacionit (IT), në Drejtorinë e Sigurisë dhe të Teknologjisë së Informacionit, në Gjykatën e Lartë, kategoria e pagës IV-1.

Në mbështetje të nenit 57 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 29 e në vijim, të kreut IV, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si dhe të udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor”, në përfundim të afatit kohor **05.09.2024** për dorëzimin e dokumentacionit për pranim në shërbimin civil gjyqësor pranë Gjykatës së Lartë, për pozicionin Specialist IT, në Drejtorinë e Sigurisë dhe të Teknologjisë së Informacionit, ju bëjmë me dije se kandidati i kualifikuar, që plotëson kërkesat e përgjithshme e të veçanta sipas shpalljes së publikuar, për të marrë pjesë në testimin me shkrim është:

1. Z. Glendi Hyka;

Njoftimi për vendin dhe orën ku do të organizohet testimi me shkrim për pozicionin e kategorisë ekzekutive **Specialist (IT) në Drejtorinë e Sigurisë dhe të Teknologjisë së Informacionit, në Gjykatën e Lartë, kategoria e pagës IV-1**, do të publikohet në vazhdim në faqen e institucionit. Gjithashtu, kandidatët do të njoftohen individualisht përmes adresës elektronike.

Ndërkohë, kandidatët e skualifikuar gjatë verifikimit paraprak për pranimin në shërbimin civil gjyqësor kanë mundësinë që të paraqesin ankim me shkrim në Gjykatën e Lartë, brenda 2 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, në zbatim të nenit 29 të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KANCELARI NË DETYRË

ANILA KULO